



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-27804/18 datë:13.09.2018



Npi – 01/249 datë: 25.09.2018

RREGULLORE

PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2019

Shtator 2018

Bazuar në nenin 12.2. pika (c) dhe nenin 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Veteqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe duke marrë për bazë nenet 10 deri në 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2018, e mbajtur më 25.09.2018, Aprovoi:

RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2019

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

QËLLIMI

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet lartësia e Taksave, Tarifave dhe Gjobave të parapara me këtë Rregullore, që janë aprovuar në Kuvendin e Komunës së Shtimes, që do t'i paguajnë personat Fizikë ose Juridikë në emër të shërbimeve të kryera, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës Komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rrënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve Komunale.

II LARTËSIA E TAKSAVE

Neni 2

Mbi bazën e Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës së Shtimes si dhe kësaj Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa, dhe Gjoba, personat fizikë ose juridikë në emër të shërbimeve të kryera Komunale do të paguajnë Tarifat si vijon:

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHËSHME

Sektori i Përgjithshëm

Neni 3

3.1 Lëshimi i Certifikatave zyrtare:

Lloji i dokumentit	Shuma €
3.1.1 Certifikata e lindjes	1.00 €
3.1.2 Ekstrakti i Lindjes	1.00 €
3.1.3 Certifikata e vdekjes	1.00 €
3.1.4 Certifikata e martesës (kurorëzimit)	1.00 €
3.1.5 Certifikata mbi statusin martesor	2.00 €
3.1.6 Deklarata me dëshmitar mbi gjendjen martesore	1.00 €
3.1.7 Certifikatë për vërtetim të atësisë dhe amësisë	1.00 €
3.1.8 Certifikatë e nënshtetësisë	1.00 €
3.1.9 Certifikatë mbi vendbanimin	1.00 €
3.1.10 Dëshmi vdekjeje.....	3.00 €
3.1.11 Vërtetime të ndryshme	1.00 €
3.1.12 Deklarata familjare	2.00 €
3.1.13 Regjistrimet e mëvonshme të lindjes, me certifikatë	5.00 €

3.1.14 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes – me certifikatë	1.00 €
3.1.15 Regjistrimi i martesës(ceremonia e martesës)	5.00 €
3.1.16 Regjistrimi i martesës (ceremonia e martesës jashtë objektit të Komunës).....	100.00 €
3.1.17 Kërkesa, Parashtrësja, Ankesa	1.00 €
3.1.18 Vërtetim i mjeteve për jetesë për botën e jashtme	5.00 €
3.1.19 Vërtetim nga Arkivi	1.00 €
3.1.20 Kërkesa për ndryshime ose përmirësime në librat AMË-s	5.00 €
3.1.21 Kërkesa për ndryshimin e emrit dhe mbiemrit	20.00 €
3.1.22 Ndërrimi i emrit dhe mbiemrit për fëmijët deri në 10 vjetë, paguhet	5.00 €
3.1.23 Për rikthimin e mbiemrit të vajzërisë paguhet taksa prej	3.00 €

3.2 Lëshimi i Certifikatave zyrtare përmes web-faqes-postes elektronike-online:

Lloji i dokumentit	Shuma €
3.2.1 Certifikata e lindjes	2€
3.2.2 Certifikata e vendëbanimit.....	2€
3.2.3 Certifikata e Martesës.....	2€
3.2.4 Certifikata e Shtetësisë.....	2€
3.2.5 Ekstrakti i lindjes	2€

3.3 Sipas nenit 3.1 Nga të gjitha pagesat lirohen këta persona: Personat në asistencë sociale, Invalidët e luftës, Familjet e dëshmorëve, Veteranët e luftës (Familja e ngushtë), Ish të burgosurit politik(vetëm individ), Invalidët civil të luftës (vetëm individ). Personat me aftësi të kufizuar (me anëtarët e ngushtë të familjes).

3.4 Gjithashtu lirohen nga të gjitha pagesat sipas nenit 3.1 edhe rastet që janë në fazën e aplikimit për asistencë sociale e të cilën gjë mund ta dëshmojnë me dokumentin nga Qendra për Punë Sociale se janë në fazë të aplikimit.

3.5 Parashtruesit e kërkesës sipas nenit 3.3 duhet të dëshmojnë se i takojnë njëres nga kategoritë e caktuara si dhe afërsinë familjare me parashtruesin e kërkesës.

3.6 Lirohen nga pagesa e taksës administrative parashtruesit e kërkesës për interes të përgjithshëm për lëshimin e dokumentit nën pikën 3.1.17 dhe 3.1.19 të cilën e bëjnë Kryetarët e Fshatrave, Bashkësive lokale, Përfaqësuesit e Shkollave, Institucioneve Publike, OJQ-ve, dhe Shoqatave Humanitare.

3.7 Nga pagesa e taksës Administrative lirohen pjestarët e komunitetit RAE në bazë të Memorandumit në mes të KK-Shtime dhe CRP/K (Programi për të Drejtat Civile në Kosovë). Përkatesia etnike e këtyre komuniteteve vërtetohet nga ana e Zyrës për Komunitete (Formulari).

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, KADASTËR DHE GJEODEZI

1. Sektori për Urbanizim dhe Ndërtim

Neni 4

4.1 Duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit Nr.04/L-110, Udhëzimin Administrativ Nr. 22/2012, si dhe Rregulloren Nr.730/30, të datës: 30.10.2011, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, përcakton këto tarifa ndërtimore për Sektorin e Urbanizmit dhe Ndërtimit:

4.2 Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2018 është: 1.40€ /m². (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit)
Formula: (Tarifa për m² x m² e ndërtimit= taksa e ndërtimit)

4.3 Taksa nga rritja e Densitetit të Infrastrukturës për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2016 është: 108.90€. (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit)
Formula:

$$\left(\frac{\text{njësia e re banuese}}{\text{(m}^2\text{)}} \times \frac{\text{nr.banorve per njësi}}{\text{(50)}} \right) \times \text{Tarifa rregullati ve për rritjen e densitetit të infrastrukturës për kokë banori}$$

4.4 Kjo Taksë përcaktohet sipas nenit 6 pika 2 të UA. 22/2012 për tarifat rregullative në Zonën e Parë dhe të Dytë të Planit Rregullues Urban 2011-2020 për qytetin, respektivisht Zonën Kadastrale Shtime.

4.5 Taksa Komunale për ndërtim të infrastrukturës, përcaktohet në bazë të nenit 17.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, dhe duhet të përcaktohet në bazë të Marrëveshjes për Infrastrukturë në mes aplikantit dhe organit kompetent të përshkruar në ligjin e Ndërtimit nr.04/L110, neni 23 dhe neni 9 i UA për Lëshimin e Lejes Ndërtimore 22/2012. Kontrata duhet të jetë ligjërish e zbatueshme që specifikon termet dhe kushte për sa i përket financimit dhe sigurimit të infrastrukturës.

4.6 Nga nenet e taksave 4.2, 4.3 dhe 4.4 lirohen ndërtimet e karakterit Bujqësor, Si dhe Subjektet Afariste në Zonën Ekonomike për Taksat e Lejeve Ndërtimore.

4.7* Kërkesa për kushte ndërtimore, pëlqime urbanistike, leje ndërtimore dhe L. përdorimi. 1.00 €
4.8 Vlerësimi profesional i objektit (për metër katror).....0.10 €
4.9 Lëshimi i vërtetimit mbi shkallën e dëmtimit të objektit1.00 €
4.10 Referenca për projektet e realizuara ne Komunën e Shtimes10.00 €
4.11 Leje për rrënimin e objektit10.00 €

4.12 Nga nenet 4.7 deri 4.11 lirohen nga taksat në bazë të Ligjit NR. 04/L-054 të datës 08.10.2011: për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, pjestarëve të UÇK-së, viktimave civile dh familjeve të tyre, në bazë të nenit 8 paragrafi 1.8 (lirim nga taksa administrative dhe publike) dhe neni 9 familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së (anëtarët e ngusht të familjeve, invalidët e UÇK-së (vetëm individi). Ndërsa në bazë të Ligjit nr. 04/L-261 datës 03.04.2014 për veteranët e luftës së UÇK-së neni 27 për lehtësira të ndryshme administrative, veteranët e luftës së UÇK-së (vetëm individi).

4.13. Ndërtimi i objekteve të infrastructures:

4.13.1 Për aktin me të cilën lejohet gropimi për ndërtimin e infrastrukturës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.13.2 Rrjet ujësjellësi (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.13.3 Rrjet kanalizimi (Për metër Gjatësi).....	0.30 €
4.13.4 Rrjet elektrike të tensionit të ulët (Për metër Gjatësi).....	0.30 €
4.13.5 Rrjet rrugorë (Për metër Gjatësi).....	0.30 €

4.14 Për aktin me të cilën lejohet gropimi për ndërtimin e trasave kablovike dhe ajrore të infrastrukturës në hapësirat publike për përsona fizik e juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.14.1 Rrjet telekomunikacioni dhe televizive (Për metër Gjatësi).....	0.40 €
4.14.2 Rrjete elektrike të tensionit të lartë (Për meter Gjatësi)	0.50 €

4.15 Për aktin me të cilën lejohet ndërtimi i objekteve te infrastrukturës në hapësirat publike për përsona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.15.1 Antena (GSM) – (Për Copë).....	150.00 €
4.15.2 Antena – internet e të ngjajshme – (Për Copë)	100.00 €
4.15.3 Trafostacionet shtyllë – (Për Copë).....	50.00 €
4.15.4 Trafostacionet Blindë – (Për Copë).....	100.00 €

2. Sektori për Mjedis

Neni 5

5.1 Për Leje Mjedisore Komunale zbatohen procedurat në bazë të Ligjit Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe neni 15 pika 1.1 dhe 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 datë 02.05.2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale.

5.1.1 Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj tarifën prej 0.2% të vlerës investuese të projektit.

3. Sektori për Kadastër dhe Gjeodezi

Neni 6

Në bazë të Udhëzimi Administrativ Nr.08/2014, i dates:16.04.2014, i Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor – Agjensia Kadastrale e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ Nr.05/2012, i dates: 11.06.2012, për tarifat e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale për regjistrimin e të drejtave të pronave të paluajtshme nga Zyra Kadastrale Komunale ku në vazhdim janë të caktuar taksat dhe tarifat e shërbimeve Kadastrale dhe Gjeodezike:

6.1 Ndërrimi i kulturave parcelave:

6.1.1 Ndërrimi i kulturës në një parcelë, pa matje gjeodezike.....	10.00 €
--	---------

6.2 Ndarja e parcelave :

6.2.1 Ndarja e një parcele në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren deri në 0.50 ha.....	75.00 €
6.2.2 Për çdo ndarje në pjesë tjetër	25.00 €
6.2.3 Ndarja parcelës në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren për 0.50ha deri 1.0ha...	100.00 €
6.2.4 Ndarja parcelës në dy pjesë sipas gjendjes faktike në terren për 1ha deri 5ha është...	150.00€
6.2.5 Ndarja e parcelës në pjesë të përcaktuara më pare (me kusht-aty ku dëshiron pala) ..	80.00 €
6.2.6 Ndarja e me tepër se dy pjese te përcaktuara me parë, për çdo pjesë tjetër	40.00 €
6.2.7 Ndarja e komplekseve me sipërfaqe 5-10ha në dy pjesë	200.00 €
6.2.8 Për çdo ndarje në pjesë tjetër	100.00 €
6.2.9 Ndarja e komplekseve me sipërfaqe mbi 10ha, në dy pjesë	500.00 €

6.2.10 Për çdo ndarje në pjesë tjetër	200.00 €
6.3 Bashkimi i parcelave:	
6.3.1 Bashkimi i dy parcelave pa matje	20.00 €
6.3.2 Për çdo parcelë tjetër në kufi	10.00 €
6.4 Rilevimi (matja) e ndërtesave:	
6.4.1 Matja për një ndërtesë individuale për 1 m ² të bazës gjeodezike	0.50 €
6.4.2 Për ç'do ndërtesë tjetër në të njëjtën ngastër, për 1 m ² të bazës gjeodezike.....	0.25 €
6.4.3 Ndërtesë banimi kolektiv, për 1 m ²	0.50 €
6.4.4 Ç'do ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1 m ²	0.50 €
6.4.5 Ndërtesa afariste, për 1 m ²	0.70 €
6.4.6 Ç'do ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1 m ²	0.70 €
6.4.7 Ndërtesa banesore afariste, për 1 m ²	0.70 €
6.4.8 Ç'do ndërtesë tjetër në të njëjtën ngastër, për 1 m ²	0.50 €
6.4.9 Ndërtesë e administratës qeveritare dhe publike, për 1 m ²	0.50 €
6.4.10 Ç'do ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1 m ²	0.50 €
6.4.11 Objekte për sport dhe rekreacion (stadione, halla sportive etj) për 1 m ²	0.50 €
6.4.12 Objekte kulturore dhe fetare, për 1 m ²	0.30 €
6.4.13 Ç'do ndërtesë tjetër në të njëjtën parcelë, për 1 m ²	0.50 €
6.5 Matjet e pjesëve të ndërtesave:	
6.5.1 Hapësirta banesore dhe përpilimi i skicës së katit të ndërtesës për 1m ²	0.80 €
6.5.2 Kati me skicat e njësive të veqanta për 1m ²	0.70 €
6.5.3 Hapësirat afariste dhe përpilimi i skicës, për 1 m ²	1.00 €
6.5.4 Ndarja e hapësirave banesore dhe përpilimi i skicës për çdo pjesë për 1 m ²	0.75 €
6.5.5 Ndarja e hapësirave afariste dhe përpilimi i skicës, për çdo pjesë	0.75 €
6.6 Matjet e Përçojave:	
7.6.1 Përçoja nëntokësore për metër gjatësi	0.50 €
7.6.2 Përçoja mbitokësore për metër gjatësi	0.25 €
7.6.3 Objekte nëntokësore	100.00 €
7.6.4 Për çdo object tjetër	50.00 €
7.6.5 Tunelet për metër gjatësi	5.00 €
6.7 Përcaktimi i kufijve të ngastrave:	
6.7.1 Për ngastër me sipërfaqe deri në, 0.50 ha	80.00 €
6.7.2 Për ngastrën me sip.prej 0.50 ha deri 1.00 ha	100.00 €
6.7.3 Për çdo hektar tjetër mbi 1.00.. ha.....	60.00 €
6.7.4 Për parcelat urbane sipas planit urban.(pas marrjes së pëlq. nga Drejtor për Urbani)	120.00 €
6.8 Rirregullimi i kufijve të parcelave:	
6.8.1 Për një parcelë me sipërfaqe deri 0.50 ha	40.00 €
6.8.2 Për sipërfaqe prej 0.50 ha deri 1.00 ha	50.00 €
6.8.3 Për çdo hektarë tjetër mbi një hektarë	30.00 €
6.9 Punët e zyrës sipas kërkesës së palëve:	
6.9.1 Identifikimi i njësive kadastrale në terren për njësi të ngastrave	20.00 €
6.9.2 Për çdo pjesë tjetër në kufi.....	5.00 €

6.9.3 Kontrollimi dhe regjistrimi në regjister i të dhënave nga tereni për njësi kadastrale20 €

6.10 Baza gjeodezike:

Pika trigonometrike:

6.10.1 Kordinatat Y,X me përshkrim5.00 €

Pikat Lidhëse:

6.10.2 Kordinatat Y,X me përshkrim4.00 €

Pikat poligonale:

6.10.3 Kordinatat Y,X,Z me përshkrim.....3.00 €

Pikë reper:

6.10.4 Kordinatat Y,X,Z me përshkrim.....5.00 €

Pikat në linjë:

6.10.5 Kordinatat Y,X,Z2.00 €

Pikat e detajit:

6.10.6 Kordinatat Y,X1.00 €

6.10.7 Vendosja e pikave trigonometrike50.00 €

6.11 Lëshimi i dokumentit nga baza e të dhënave kadastrale tekstuale apo grafike sipas kërkesave të palëve nga ZKK:

6.11.1 Certifikata mbi pronën.....4.00 €

6.11.2 Kopja e planit format A-4 për një kopje5.00 €

6.11.3 Kopja e planit format A-4 për çdo parcelë tjetër – plus2.00 €

6.11.4 Kopja e hartës kadastrale AO,letër e thjeshtë1:500, 1000,1:5000.....20.00 €

6.11.5 Dhënja e vërtetimeve të ndryshme.....3.00 €

6.11.6 Historiati për një parcelë.....30.00 €

6.12 Punët e veçanta gjeodezike:

6.12.1 Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekt individual. për m² ... 0.50 €

6.12.2 Bartja në teren e të dhënave nga planet urbanistike për objekte të banimi kolektiv apo afarist për m²0.50 €

6.13 Rexhistrimi i kontratave të shitëblerjes së patundshmërive bëhet sipas vlerës së kontratave si vijon:

6.13.1 Për vlerën e transaksionit deri 10.000 € - paguhet taksa në shumën prej20 €

6.13.2 Për vlerën e transaksionit prej 10.000 € deri 30.000 € paguhet taksa në shumën.....30 €

6.13.3 Për vlerën e transaksionit prej 30.000 € deri 50.000 € paguhet taksa në shumën.....35 €

6.13.4 Për vlerën e transaksionit prej 50.000 € deri 100.000 € paguhet taksa në shumën.....50 €

6.13.5 Për vlerën e transaksionit prej 100.000 € deri 150.000 € paguhet taksa në shumën.....80 €

6.13.6 Për vlerën e transaksionit prej 150.000 € deri 200.000 €paguhet taksa në shumën.....110 €

6.13.7 Për vlerën e transaksionit prej 200.000 € deri 250.000 €paguhet taksa në shumën.....140 €

6.13.8 Për vlerën e transaksionit prej 250.000 € deri 300.000 €paguhet taksa në shumën.....170 €

6.13.9 Për vlerën e transaksionit prej 300.000 € deri 350.000 €paguhet taksa në shumën.....200 €

6.13.10 Për vlerën e transaksionit prej 350.000 € deri 400.000 € paguhet taksa në shumën...230 €

6.13.11 Për vlerën e transaksionit prej 400.000 € deri 450.000 € paguhet taksa në shumën...260 €

6.13.12 Për vlerën e transaksionit prej 450.000 € deri 500.000 € paguhet taksa në shumën.. 290 €

6.13.13 Për vlerën e kontratës - transaksionit i cili tejkalon vlerën mbi 500.000 € paguhet taksa fikse në shumën prej 300 €

6.13.14 Nëse kontrata është e pa vlerësueshme paguhet taksa në shumë prej70 €

6.13.15 Regjistrimi i të drejtave në pronë të patundshme në bazë Aktgjykimit Civil paguhet taksa në shumën prej 50 €.

6.13.16 Regjistrimi i të drejtave në pronë të paluajtshme në bazë të pjestimit (ndarjes) të pronës në bashkëpronësi paguhet taksa në shumë prej 20 € për secilin person.

6.13.17 Regjistrimi i të drejtave në pronë të paluajtshme në bazë të trashigimisë paguhet taksa në shumë prej 10 € për çdo trashigimtarë.

6.13.18 Regjistrimi i të drejtave në pronë të paluajtshme në bazë ndërrimit të pronës së paluajtshme paguhet taksa në shumën prej 30 € për secilin pronar-posedues.

6.14 Rexhistrimi i kontratave të dhuratës patundshmërisë bëhet sipas vlerës së kontratave:

	Antar jo i familje	Antari i familjes
6.14.1 Për vlerën e transaksionit deri 10.000 € - paguhet taksa në shumën....	20 €	6 €
6.14.2 Për vlerën e trans. prej 10.000 € deri 30.000 € paguhet taksa	30 €	9 €
6.14.3 Për vlerën e trans. prej 30.000 € deri 50.000 € paguhet taksa.....	35 €	10.5 €
6.14.4 Për vlerën e trans. prej 50.000 € deri 100.000 € paguhet taksa.....	50 €	15 €
6.14.5 Për vlerën e trans. prej 100.000 € deri 150.000 € paguhet taksa.....	80 €	24 €
6.14.6 Për vlerën e trans. prej 150.000 € deri 200.000 € paguhet taksa.....	110 €	33 €
6.14.7 Për vlerën e trans. prej 200.000 € deri 250.000 € paguhet taksa.....	140 €	42 €
6.14.8 Për vlerën e trans. prej 250.000 € deri 300.000 € paguhet taksa.....	170 €	51 €
6.14.9 Për vlerën e trans. prej 300.000 € deri 350.000 € paguhet taksa.....	200 €	60 €
6.14.10 Për vlerën e trans. prej 350.000 € deri 400.000 € paguhet taksa.....	230 €	69 €
6.14.11 Për vlerën e trans. prej 400.000 € deri 450.000 € paguhet taksa	260 €	78 €
6.14.12 Për vlerën e trans. prej 450.000 € deri 500.000 € paguhet taksa	290 €	87 €

6.14.13 Anetarë të familjs së ngushtë në vije të drejtë konsiderohen: – (nga gjinia e gjakut)
konsiderohen: Prindërit, Djali, Vajza, Nipi, dhe Mbesa.

6.14.14 Për vlerën e kontratës mbi dhuratën e cila tejkalon vlerën mbi 500.000 €, paguhet taksa fikse në shumën prej 300 € për dhuratmarrësit që nuk jan anëtar të ngusht të familjes së dhuratëdhënësit. Ndërsa në Shumen pre 90 € paguhet taksa për anëtarët e ngusht të familjes së dhuratëmarrësit me të dhuratëdhënësit.

6.14.15 Nëse kontrata është e pa vlerësueshme e që dhuratmarrës janë antarët e ngusht të dhuratëdhënësit, taksa paguhet në shumë prej 50 € për çdo pronar.

6.14.16 Nëse kontrata është e pa vlersueshme e që dhuratmarrës nuk janë anëtarë të ngusht të familjes së dhuratdhënësit, taksa paguhet në shumen prej 80 € për çdo pronar.

6.15 Regjistrimi i hipotekave bëhet sipas vlerës së kontratës:

6.15.1 Kredia në vlerën prej deri në 10.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	10 €
6.15.2 Kredia në vlerën prej 10.000€ - 30.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	20 €
6.15.3 Kredia në vlerën prej 30.000€ - 50.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	30 €
6.15.4 Kredia në vlerën prej 50.000€ - 100.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	80 €
6.15.5 Kredia në vlerën prej 100.000€ - 200.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	110 €
6.15.6 Kredia në vlerën prej 200.000€ - 300.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	140 €
6.15.7 Kredia në vlerën prej 300.000€ - 400.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	170 €
6.15.8 Kredia në vlerën prej 400.000€ - 500.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	200 €
6.15.9 Kredia në vlerën prej 500.000€ - 600.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	230 €

6.15.10 Kredia në vlerën prej 600.000€ - 700.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	260 €
6.15.11 Kredia në vlerën prej 700.000€ - 800.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	290 €
6.15.12 Kredia në vlerën prej 800.000€ - 900.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	320 €
6.15.13 Kredia në vlerën prej 900.000€ - 1.000.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	350 €
6.15.14 Kredia në vlerën prej 1.000.000€- 1.100.000€ paguhet taksa në shumën prej.....	380 €
6.15.15 Kredia në vlerë mbi 1.100 .000 € - paguhet taksa në shumën fikse prej.....	400 €
6.15.16 Ndryshimi i Hipotekës së regjistruar – paguhet taksa në shumë prej	30 €
6.15.17 Fshirja e Hipotekave: Kërkesa lidhur me fshirjen e hipotekave nga rexhistri i të drejtave mbi pronën e paluajtshme duhet të paguhet taksa në shumën prej:.....	10 €

6.16 Regjistrimi i servitutit dhe barrave tatimore:

- 6.16.1 Regjistrimi i të drejtës së servitutit në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme bëhet duke paguar tarifen në shumë prej: 50€.
- 6.16.2 Fshirja e servitutit nga regjistri bëhet duke paguar tarifen në shumën prej: 20€.
- 6.16.3 Regjistrimi i barrës në tatimin në pronen paluajtshme paguhet tarifa në shumë prej: 20€
- 6.16.4 Regjistrimi i barrës tatimore bëhet duke paguar tarifen në shumë prej: 30€
- 6.16.5 Regjistrimi i masës së sigurisë përkohshme të udhëhequr me kërkesë të palës private duhet të paguhet tarifa në shumë prej: 50€.

6.17 Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtja:

- 6.17.1 E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje prej 3-10 vite mund të regjistrohet duke paguar në shumën prej: 50€.
- 6.17.2 E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja në kohëzgjatje prej 10-25 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifen në shumën prej: 150€
- 6.17.3 E drejta e shfrytëzimit – qirambajtja me kohëzgjatje prej - 99 vite mund të regjistrohet duke paguar tarifen në shumën prej: 500€.
- 6.17.4 Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtja bëhet duke paguar 20% e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit.
- 6.17.5 Regjistrimi i bartjes së drejtës së shfrytëzimit qirambajtjes - ose nenqirase tek personat e treta paguhet tarifa e cila përcaktohet në nenin 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ.

6.18 Regjistrimi i të drejtave tjera:

- 6.18.1 Regjistrimi të drejtave, ngarkesave, barrës pronësore e tjera mbi pronën e paluajtshme të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e U.A. të MMPH-ë, Nr.08/2014 do të regjistrohen duke paguar tarifen në shumën prej 40.00€.
- 6.18.2 Nëse të dhënat që duhet të korrigjohen janë futur në regjister sipas dokumentacionit të dorëzuar nga palët, korrigjimi i tyre bëhet duke paguar pala shumën prej 20.00€.

6.19 Nga neni 5.11.1, Lirohen nga pagesa e Taksave Komunale për lëshimin e dokumentacionit, siç janë Certifikatat mbi pronësinë dhe Vërtetime tjera mbi pronësinë, Certifikata që nuk kanë pronësi, personat e përfshirë në kategoritë e dala nga lufta si vijon: Invalidët e luftës (individi), Familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së (familja e ngushtë). Lirimi bëhet mbi bazën e nenit 8.1.8 dhe nenit 9.1.13 të Ligjit për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjestarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, Nr.04/L-054, të dtës 08.10.2011.

6.20 Nga neni 5.11.1, në bazë të nenit 27 të Ligjit për Veteranët e Luftës së UÇK-së Nr.04/L-261, dt.3.04.2014; Lirohen Veteranët e UÇK-së (vetëm individi).

6.21 Lirohen personat në asistence sociale, duke përfshirë edhe ata që gjinden në fazën e aplikimit të cilët mund ta dëshmojnë me dokumentin nga Qendra për Punë Sociale se janë në fazë të aplikimit.

6.22 Nga neni 5.11.1, Lirohen nga pagesa e Taksave Komunale për lëshimin e dokumentacionit, siç janë Certifikatat mbi pronësinë dhe Vërtetime tjera mbi pronësinë, Certifikata që nuk kanë pronësi, pjestarët e komunitetit RAE në bazë të Memorandumit në mes të KK-Shtime dhe CRP/K (Programi për të Drejtat Civile në Kosovë). Përkatesia etnike e këtyre komuniteteve vërtetohet nga ana e Zyrës për Komunitete (Formulari).

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Sektori për Inspektorat dhe Mjedis

Neni 7

7.1 Pëlqimi Komunal për aktivitete biznesi:

7.1.1 Regjistrimi për punë me auto-taxi, dhe kioskat	15.00€
7.1.2 Vazhdimi i regjistrimit të lejeve për auto-taxi	10.00€
7.1.3 Ndarja e vijave të reje të autobusit urban dhe periferik	50.00€
7.1.4 Vazhdimi i linjave të autobusit në trafikun urban dhe periferik.....	30.00€

7.2 Pëlqimi Higjieniko-teknik e Sanitar për subjektet afariste, mbi bazën e Ligjit për Inspektoriatin Sanitar, Nr.2003/22:

7.2.1 Objektet industriale.....	10.00 €
7.2.2 Shitja e derivateve të naftës (pompat e benzinës), depot e gazrave.....	25.00 €
7.2.3 Restorantet, hotelet, motelet, therrtoret, objektet për prodhimin e ushqimit	25.00 €
7.2.4 Ordinancat shendetsore private, barnatoret mjeksore, barnatoret bujqesore dhe laboratorët biokimike.....	25.00 €
7.2.5 Vetshërbimet Sh.p.k.....	25.00 €
7.2.6 Kuzhinat (gjelltorët)	15.00 €
7.2.7 Ëmbëltoret, Kafiterit.....	15.00 €
7.2.8 Dyqanet tregëtare të pavarura	10.00 €
7.2.9 Dyqanet e pavarura zejtare-tregëtare.....	10.00 €
7.2.10 Dyqanet e pavarura zejtare-shërbyese.....	10.00 €
7.2.11 Zyret dhe agjensitë	10.00 €
7.2.12 Kiosqet.....	5.00 €
7.2.13 Gurethyesit, Betonjerkat, eksploatuesit e zhavorit	25.00 €
7.2.14 Veprimtarit Shërbyese në sektorin e Teknologjis Informative dhe produkteve të tyre dhe të gjitha veprimtarit e kësaj lamiye.....	25.00 €

7.2.15 Mos paisja me pëlqime sanitare, mjedisore dhe aktet tjera zyrtare do të zbatohen dispozitat ndeshkuese me ligjet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.

7.2.16 Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetent Inspektorati Komunal dhe Policia e Kosovës.

7.3 Pëlqimin e Mbrojtjes nga Zjarri, lëshohet konform nenit 13 të Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri Nr.04/L-012:

7.3.1 Për tu paisur me Pëlqimin e mbrojtjes nga zjarri, aplikuesi duhet të paguaj.....20.00 €

7.4 Lejet për qarkullimin e automjeteve të rënda motorike në rrugët ku është ndaluar qarkullimi i automjeteve në fjalë, për ngarkim – shkarkim të mallit mbi 7 tonë:

7.4.1 Leje në rrugët "T. Sinani" "Komandant Kumanova" dhe "A. Jashari" 1 deri 3 ditë...10.00 €

7.4.2 Leje për të gjitha rrugët tjera - 1 deri 3 ditë5.00 €

7.4.3 Leje - 1 deri 15 ditë15.00 €

7.4.4 Leje mujore25.00 €

7.4.5 Leje vjetore250.00 €

7.4.6 Të gjithë operatorët që nuk janë të komunës së Shtimes e të cilët furnizohen apo furnizojnë bizneset në komunën e Shtimes duhet të deshmojnë me faturë furnizimi apo shitje të mallrave neper keto biznese që kanë leje qarkullim mbi 7 tone, e cila leshohet për të gjitha veprimtaritë e bizneset në komunën e Shtimes vetëm neper rrugët të cilat janë të lejuara me rregullore komunale.

Neni 8

8.1 Taksa për pronësinë në automjet:

8.1.1 Të gjithë pronarët – poseduesit e automjeteve motorike në Komunën e Shtimes të cilat rexhistrohen duhet të paguajnë taksën Komunale sipas kësaj tablele:

Nr.	Emërtimi – Lloji i Automjeteve	Shuma €
1.	-Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme deri në 3500 kg. -Të gjitha llojet e Motoçikletave që rexhistrohen.	10.00
2.	- Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme mbi 3500 kg. - Të gjithë Autobusët dhe Minibusët.	20.00
3.	- Lirohen nga pagesa të gjitha llojet e Rimorkios, Traktorët dhe mjetet tjera bujqësore.	00.00

8.2 Nga Taksa për pronësinë në automjet lirohen:

8.2.1 Automjetet e: Emergjencës, Zjarrëfiksive, Policisë, Komunës, Shoqatave jo qeveritare, Ushtarake, dhe të organizmave ndërkombëtarë - Dëshmi për këtë është Libreza e Automjetit.

8.2.2 Familja e ngushtë e Dëshmorëve të UÇK-së, dhe Invalidët e luftës së UÇK-së;

8.2.3 Personat me Invaliditet ushtarak dhe të punës, dëshmi për këtë është: Vendimi mbi Invaliditetin nga Ministria e Punës.

8.2.4 Personat me aftësi të kufizuara.

8.3 Taksa Komunale për shfrytëzimin e Pronës Komunale me destinacion të përkohshëm:

8.3.1 Kiosqet (Qoshqet), Objektet Montazh etj. në Komunën e Shtimes janë të obliguar të paguajnë taksën për një Muaj sipas kësaj tablele:

Nr.	Zonat	Sasia	Çmimi për 1 Muaj
1	Zona e parë	1 m ²	2 €
2	Zona e dytë	1 m ²	1 €
3	Zona e tretë	1 m ²	0.5 €
4	Zonat rurale	1 m ²	0.5 €

8.4 Taksat për shfrytëzimin e hapsirave të tregut sipas llojeve paguhen sipas kësaj tablele:

Nr	Tregu	Përshkrimi	Ditët	Njësia matëse	Çmimi për Një Ditë €	Çmimi për Një Vit (Rezervim)
1.	I Plaçkave dhe i gjelbër	Tezgë – Lokacion për shitje të Mallit	E premtë	1 m ²	1.00	(2 m ²) 100.00 €
2.	I Plaçkave dhe i gjelbër	Tezgë – Lokacion për shitje të Mallit	Për ç' do ditë	1 m ²	0.50	(2 m ²) 150.00 €
3	I Plaçkave dhe i gjelbër	Lokacioni (polygon) për Autoshkolla	Përveç ditës së Premte		Paushall	Çmimi për Një Muaj 30€
4.	I Kafshëve	Kafshët e trasha	E premtë	1 Copë	2.00	/
5.	I Kafshëve	Kafshët e imëta	E premtë	1 Copë	0.50	/
6.	I Gjëlber dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkio, etj.	E premtë	1m. gjatësi	1.00	/
7.	I Gjëlber dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkio, etj.	Për ç' do ditë	1m. gjatësi	0.50	Deri 3500 kg - 100.00€ Mbi 3500 kg - 150.00€
8.	I Plaçkave dhe i gjelbër	Parkimi i automjeteve	Përveç e Pre. e Shtu. e Diel	1 Copë	0.50	/
9.	I Kafshëve	Peshorja e kafshëve	Për një vit	Paushall	/	150.00€
VËREJTJE: Zhavorri ose materiali tjetër ndërtimor nuk është i lejuar të zbrazet në tokë, në lokacionin e tregut.						

8.5 Taksat për shfrytëzimin e hapësirave publike në Komunën e Shtimes, paguhen sipas kësaj tablele:

PAGESA SIPAS ZONAVE -€					SHFRYTËZIMI I PËRKOHSHËM I HAPSIRAVE KOMUNALE-PUBLIKE:
Për Muaj	Zona I	Zona II	Zona III	Zona Rurale	
1	5	4	3	2	1. Shitje sezonale të Lëvizshme, (Frigorifer, Fara, Cigare etj) 2. Vendorsje të Panairëve, Tregje dhe Reklamim të automjeteve, 3. Shfrytëzimi i sipërfaqes për Reklam. të mallrave të ndryshëm 4. Vendorsja e Reklamave, pagesa për metër katror të reklamës, 5. Vendorsja e Verandave, Pushimoreve, Çadrave për biznese etj, 6. Vendorsje të pajisjeve për lojëra të ndryshme dhe argëtim, 7. Vendorsje të përkohshme të pajisjeve dhe materialit për ndërtim, 8. Vendorsje të Kontejnerëve për mbeturina ricikluese për m ³ . 9. Shfrytëzimi i sipërfaqes- hapësirës publike për nevoja të ndryshme të qytetarëve. 10. Pagesa për parkimin e automjetit, dhe me rimorkio në Parkingun Publik në Rrugën kryesore - Shtime është 0.20€ (Njëzet cent) për një orë.
2	8	6.40	4.80	3.20	
3	12	9.60	7.20	4.80	
4	16	12.80	9.60	6.40	
5	20	16	12	8	
6	24	19.20	14.40	9.60	
7	28	22.40	16.80	11.20	
8	32	25.60	19.20	12.80	
9	36	28.80	21.60	14.40	
10	40	32	24	16	
11	44	35.20	26.40	17.60	
12	48	38.40	28.80	19.20	

8.6 Për dhënien e Objekteve të mëdha ose sipërfaqeve të tokës, Komunale-Publike me qira ose në forma tjera për shfrytëzim afatshkurtë ose afatgjatë, kërkesa e palës duhet të i nënshtrohet procedurës administrative, sipas Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës dhe Rregulloreve të Komunës së Shtimes, dhe për të vendos Kuvendi i Komunës ose Organet e tij.

DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Sektori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Neni 9

9.1 Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në jobujqësore

9.1.1 Me këtë bëhet caktimi ndryshimit të destinimit të sipërfaqeve bujqësore sipas Udhëzimit Administrativ, Nr.41/2006, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

9.1.2 Në komunën e Shtimes sipas strukturës së sipërfaqeve bujqësore ekzistojnë tetë klasë.

9.1.3 Kompensimi për ndryshim të destinimit të Tokës sipas klasave bëhet sipas tabelës në vijim:

Klasa I-rë deri IV-të	Kompensimi	1.00 €/m ²
Klasa V-të dhe VI-të	Kompensimi	0.75 €/m ²
Klasa VII-të dhe VIII-të	Kompensimi	0.50 €/m ²

9.1.4 Përcaktimi i këtyre kuotave financiare sipas kategorive dhe klasave është rezident vetëm për zonën urbane të ndarë në tri zona.

9.1.5 Përjashtime nga neni 8.1.4 mund të bëhen vetëm për rastet kur ndërrimi i destinimit të tokës ka të bëjë me ndërtimin e Objekteve bujqësore, Fermave, Fidanishteve, Serrave e objekteve me karakter zhvillimi të bujqësisë.

9.1.6 Vërtetim për marrje me veprimtari bujqësore, kompensimi për persona fizikë2.00 €

Sektori për Zhvillim Ekonomik

9.2 Certifikata që ka të bëjë me vlerësimin e pronës dhe kapitalit:

9.2.1 Pagesa në rastin kur lëshohet nga zyra mbi provat (dokumentacionit)5.00 €

9.2.2 Pagesa në rastin kur duhet bërë vlerësimin përmes komisionit profesional në teren dhe kur duhet sajuar procesverbalin përkatës 25.00 €

9.2.3 Vërtetime të ndryshme1.00 €

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Neni 10

10.1 Tarifat Komunale për dokumentat që lëshon DSHMS-ë dhe QPS-ë:

10.1.1 Vërtetim për Dëshmorët.....(lirohen)

10.1.2 Formulari për trajtim jashtë vendit.....(lirohen)

10.1.3 Vërtetimi për skemën invalidore dhe të plagosurit e luftës.....(lirohen)

10.1.4 Vërtetim nga participimi.....(lirohen)

10.1.5 Vërtetim i gjendjes Sociale.....1.00 €

10.1.6 Vërtetimet tjera1.00 €

10.1.7 Vërtetim që nuk i është marrë e drejta për të vepruar apo e drejta prindore2.00 €

10.1.8 Vërtetim për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës3.00 €

10.1.9 Vërtetim për pranim të shtetësisë së Republikës së Kosovës2.00 €

10.1.10 Vërtetim që familja nuk merr asistencë sociale (për shtetet e jashtme)2.00 €

10.1.11 Vërtetim (mendimi) për martesë të parakohshme3.00 €

10.1.12 Vërtetim për rexhistrim të më vonshëm të fëmijëve2.00 €

10.1.13 Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijë	2.00 €
10.1.14 Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimi	2.00 €
10.1.15 Pëlqim për bartjen e pasurisë	2.00 €
10.1.16 Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijët e moshës jo madhore	2.00 €
10.1.17 Kërkesë për përfaqësim në Gjykata për fëmijët lidhur me trashëgimi.....	3.00 €
10.1.18 Konstatime të ndryshme zyrtare	3.00 €
10.1.19 Pranim i Atësisë dhe Amësisë	3.00 €

10.2 Duke u bazuar në U.A. Nr.04/2007 të datës 24.09.2007 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesa e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve shëndetsore, çmimet e pagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit paresor është:

Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike	1.00
10.2.1 ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë	1.00
10.2.2 Egzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes	2.00
10.2.3 Egzaminimi specialistik në QMF/QKMFpa udhëzim të Mjekut të Familjes	5.00
10.2.4 Egzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente	6.00
10.2.5 Medikamenti nga lista esenciale ,ofruar në barnatoren publike	0.30
10.2.6 Ultrazëri standard	2.00
10.2.7 Radiografia	2.00
10.2.8 EKG	0.50
10.2.9 Analizat Laboratorike-vetëm hemogrami dhe urina	1.00
10.2.10 Analizat laboratorike (komplet)	3.00
Caktimi I sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkeses së shfrytëzuesit të	
10.2.11 shërbimeve shëndetësore	1.00
10.2.12 Audiograma	1.00
10.2.13 Shpërlarja e veshit	1.00
10.2.14 Dhënja e injeksionit Intra muskular në shtëpi ,përpos në rastet emergjente	1.00
10.2.15 Dhënja e injeksionit Intra venoz në shtëpi ,përpos në rastet emergjente	1.00
Përpunimi I plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës	
10.2.16 (vetëm në viziten e parë)	3.00
10.2.17 Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor	1.00
10.2.18 Certifikata për lejen e vozitjes e leshuar nga konsiliumi I profesionistëve	18.00
Certifikata mjekësore e leshuar sipas kërkeses së shfrytëzuesit të	
10.2.19 shërbimeve shëndetsore	18.00
Dhënja e raportit mjekësor ,vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të	
10.2.20 kërkeses së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetsore	5.00
10.2.21 Ofrimi I shërbimeve shëndetsore gjatë aktivitetve sportive, etj- për një orë	25.00
10.2.22 Vizitë e parë stomatologjike	1.00
10.2.23 RTG I dhëmbit	1.50
10.2.24 Mbushje e përhershme me amalgam	4.00
10.2.25 Mbushje e përhershme me kompozitë	5.00
Shërimi biologjik I dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgam apo	
10.2.26 kompozitë)	5.00

10.2.27	Amputimi vital I pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00
10.2.28	Extirpimi vital I pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00
10.2.29	Amputimi mortal I pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00
10.2.30	Extirpimi mortal I pulpës me mbushje të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00
10.2.31	Terapia e kanalit të infektuar të përhershme (amalgam apo kompozitë)	6.00
10.2.32	Rindërtimi konzervativ I dhëmbit me bushje të përhershme	6.00
10.2.33	Revizioni I mbushjes së kanalit të rrënjes	1.00
10.2.34	Fluorizimi I dhëmbëve sipas seancave	1.00
10.2.35	Vulosja e fisurave	1.00
10.2.36	Mënjanimi I depozitimeve të buta	1.00
10.2.37	Mënjanimi I depozitimeve të forta (heqja e gurëzëve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00
10.2.38	Kiretazha e xhepave parodontal (një dhëmb)	1.00
10.2.39	Nxjerrja e dhëmbit	1.50
10.2.40	Incizioni intra dhe extra oral	1.50
10.2.41	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00
10.2.42	Riparimi I protezës (ngjitja)	1.50

DREJTORIA PËR ARSIM

Neni 11

11.1 Duke u bazuar në U.A. Nr.11/2011 të datës 30.12.2011 të MASHT-it, pagesa e vijuesve për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimit për të rritur është:

11.1.1	Për regjistrim të vitit (për një klasë).....	100.00 €
11.1.2	Për praktikë profesionale	50.00 €
11.1.3	Provimi diferencial	10.00 €
11.1.4	Për provimet përfundimtare të klasës, certifikatën.....	30.00 €
11.1.5	Për diplomë të përfundimit të shkollimit.....	20.00 €

11.2 Duke u bazuar në U.A. Nr.03/2013 të datës 21.01.2013 të MASHT-it, dokumentacioni dublikatë lëshohet nga institucionet e arsimit përkatës në këto raste:

11.2.1	Nëse është i humbur.....	1.00 €
11.2.2	Nëse është djegë.....	1.00 €
11.2.3	Nëse është dëmtuar.....	1.00 €
11.2.4	Nëse është asgjësuar.....	1.00 €
11.2.5	Nëse është i plotësuar me gabime.....	1.00 €

11.3 Duke u bazuar ne vendimin Npi-01/238, date 15.09.2011 te Kuvendit Komunal te Shtimës për caktimin e tarifës participuese të fëmijëve në çerdhe kemi:

11.3.1	Pagesa për qëndrim ditor te fëmijëve ne Institucion Parashkallor.....	35€/muaji
11.3.2	Shfrytëzimi i hapsirave të mbrendshme te Shkollave për rekreacion.....	10€/ora

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 12

12.1 Lartësia e ngarkesave që do të paguajnë personat fizikë ose juridikë në emër të shërbimeve apo të veprimtarive Kulturore Komunale do të jen si vijon:

Për Bibliotekë pagesat vjetore të antarsimit janë:

12.1.1 Sektori për të rritur mbi moshën 18 vjeq.....2.00 €/vit

12.1.2 Sektori për fëmijë nën moshën 18 vjeq.....1.00 €/vit

Për Aktivitetet në Shtëpinë e Kulturës pagesat janë:

12.1.3 Bileta për përcjelljen e shfaqjeve teatrore1.00 €

12.1.4 Bileta për përcjelljen e shfaqjeve për fëmijë.....1.00 €

12.1.5 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete jo kulturore.....30.00 €/orë

12.1.6 Lirohen nga pagesa për pjesëmarrje në aktivitetet kulturore këto kategori: fëmijet e dëshmorve, fëmijet e invalidve të luftës, fëmijet e veteraneve, pensionistet, rastet sociale, personat me aftësi të kufizuar si dhe vullnetarët të cilët posedojnë deshmë sipas kategorisë së përcaktuar.

III DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 13

Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, marrjen e lejes për shfrytëzim.

IV DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha e vitit 2018, me numër Nr.01/060/01-27185/17-251, datë: 15.09.2017.

Neni 15

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisjen Lokale, dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës.

Neni 16

Implementimin e kësaj rregullore janë të obliguar ta bëjnë: Kryetari, të gjitha Drejtoritë Komunale si dhe Institucionet në nivelin e lokal të komunës së Shtimes, nga 01.01.2019.

Neni 17

Rregullorja dhe Vendimi u dërgohen: Arkivit, Drejtorive, Institucioneve lokale, Zyrës për Informim, Kryetarit të Komunës, MAPL-së, MEF-it.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj